

Kompania Regjionale e Mbeturinave "Ambienti" Sh.A .Pejë  
Me adresë Rr.Xhem Sadrija pn ,Fusha e Pejës-Tranzit KK Pejë

Bazuar ne ligjin e Punës: LIGJI Nr. 03/L-212 sipas neni 8,dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ MFPT- NR 01/2024, dhe rregulloren e brendshëm për rregullimin e procedurave te konkursit nr 3090 e datës 21.11.2025 Kryeshefi Ekzekutiv i Kompanisë Regjionale të Mbeturinave "Ambienti" Sh . A .Pejë me datë 05.05.2026, shpall konkurs të jashtëm për këto vende të punës :

## KONKURS

### Pozita : Mbledhës i borxhit (inkasant) - 1 pozitë

Vendi punës : Pejë

Kohëzgjatja e periudhës provuese është 6 muaj me mundësi vazhdimi sipas kontratave të ligjit të punës.

Koeficienti i pagës : 2

#### Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

1. Obligohet që në terren të silltet korrekt dhe të ketë të veshur uniformë me shenjë identifikimi të ndërmarrjes NPL Ambienti Sh.A.
2. Dërgon faturat e printuara mujore që është i ngarkuar tek secili klient. Çdo parregullësi në faturë duhet ta kthej në rilllogaritje (korrigjim) tek Udhëheqës i Inkasimit dhe arkëton pagesat më bllok të vërtetuar nga ndërmarrja.
3. Përcjell gjendjen në terren dhe regjistron klientë të rinj, ndërrimin e pronarëve, pasivizimet, korrigjimet e adresave dhe merr shënimet tjera të cilat i përkasin punëve dhe detyrave të inkasantit në lidhje me terrenin e tij dhe të njëjtat i dorëzon te Udhëheqës i Inkasimit.
4. Në çdo kohë udhëheqësi i inkasantëve dhe inspektorëve mund të kontrollojnë terrenin e inkasantit përgjegjës dhe në evidentimin e problemeve të paevidentuara nga inkasanti, ata do të shqiptojnë vërejtje.
5. Dorëzon arkëtimet e pagesave me shënimet e duhura tek faturistët.
6. Në bazë të raportit të lëshuar nga faturistët (Arkëtimi sipas Dokumenteve Analitke), kontrollon raportin së a janë në përputhje me pagesat në bllokun e dorëzuar dhe pasi që janë të gjitha në rregull bën dorëzimin e mjeteve në arkë.
7. Pas dorëzimit të mjeteve në arkë, nënshkruan mandat arkëtim të dokumentit dhe atë urdhër e ruan për barazim mujor tek Udhëheqës i Inkasimit.
8. Jep përgjegjësi për çdo dëftesë të lëshuar nga blloku i tij me numër serik.
9. Jep përgjegjësi për çdo faturë të dyfishuar dhe çdo formë tjetër, ku dëmtohet buxheti i ndërmarrjes.
10. Kryen punë bazuar në kontratën e punës, por edhe punë të tjera me urdhëresë të Udhëheqës i Inkasimit.
11. Është i detyruar të zbatojë disiplinën në punë, kodin e etikës, rregulloret / rregullat e caktuara nga ndërmarrja, ku për këtë proces pune dhe në rast të shkeljes së tyre mban përgjegjësi disiplinore.
12. Për mosrespektimin e pikave të lartcekura i përgjigjet drejtpërdrejt Kryeshefit Ekzekutiv.

#### a. Kushtet e përgjithshme :

- CV;
- Çertifikatë që kandidati nuk është nën hetime;
- Letër motivimi;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Çertifikatë mbi gjendjen shëndetësore.

#### b. Kushtet e veçanta :(kualifikimet profesionale)

- Shkolla e mesme (preferohet shkolla e mesme ekonomike);
- Përparësi përvojë pune e dëshmuar;
- Ai /Ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën presion, të ketë moral të fortë për punë dhe integritet të nivelit të lartë.

**Mënyra e Aplikimit :** Dokumentacioni duhet të dërgohen ne e-mailit [krmambientikonkurset@gmail.com](mailto:krmambientikonkurset@gmail.com)

Data e për aplikim është nga 05.05.2026 deri me 20.05.2025 ora 12:00. Dokumentacioni që mbërrin pas afatit dhe i pakompletuar do të konsiderohet i pavlefshëm.. Dokumentet origjinale mund të kërkohen, sipas nevojës. Vetëm kandidatët e selektuar për listën e ngushtë do të kontaktohen.